REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr.1337 Prot

Shkodër, më 12. 11 .2026

U R D H Ë R

Nr. 160 , Datë 12 . 11 .2026

"PËR HAPJEN E AFATIT TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE TË KRIJUARA PËR ANËTARË TË KIZ DHE KA"

Bazuar në nenin 36, pika 7, dhe nenin 39, të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", neni 6, pika 1, gërma a); c) dhe nenit 35, pika 5; për arsye të mbarimit të mandatit të 3 (tre) anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve dhe të 1 (një) anëtari të Komisionit të Apelimit;

U R D H Ë R O J

1. Hapjen e aplikimit për plotësimin e 3 (tre) vakancave të krijuara në KIZ, për një përfaqësues nga Fakulteti Ekonomik, një përfaqësues nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, si dhe 1 (një) përfaqësues nga radhët e studentëve.
2. Hapjen e aplikimit për plotësimin e 1 (një) vakance të krijuar në Komisionin e Apelimit.
3. Të drejtën për tu vetëkandiduar për anëtarë të KIZ e kanë personeli akademik me kohë të plotë në Fakultetin Ekonomik, personeli akademik me kohë të plotë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, si dhe studentët e USH-së.
4. Të drejtën për tu vetëkandiduar për anëtarë të KA, e kanë personeli akademik me kohë të plotë në USH.
5. Dorëzimi i aplikimeve do jetë deri ditën e hënë, datë 16.11.2026, ora 8- 16:30, pranë sekretarisë së Senatit Akademik.
6. Ky Urdhër përcillet për njohje e zbatim pranë të gjitha njësive kryesore të USH-së, studentëve, si dhe publikohet në faqen zyrtare të USH-së.
7. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Bleru Dragushu